



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr.        prot

Tiranë, më 19.05.2009

**V E N D I M**

**Nr.113 Datë 19.05.2009**

**Për**

**“ Ndalimin e marrëveshjes në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit midis ndërmarrjeve “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati)    Kryetar
- Znj. Servete Gruda        Anëtar
- Z. Koço Broka              Anëtar
- Znj. Rezana Konomi        Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.05.2009, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:**                      Shqyrtimin e raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit

**Baza ligjore:**                Ligji nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 4, pika 1, germa a), b) dhe c), neni 24, shkronja d), dhe neni 45, pika 1

Komisioni i Konkurrencës, pasi shqyrtoi Raportin e grupit të punës për hetimin e thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, të hapur me Vendimin Nr. 88 datë 02.10.2008 të Komisionit të Konkurrencës, dhe relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm:

**K O N S T A T O I :**

Në raportin e Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës mbi hetimin e thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, rezulton se dy nga ndërmarrjet nën hetim “Atlas” Sh.a dhe “Bloja” Sh.a”:

1. Mbajnë të dhëna të plota mbi importet e kryera nga secila prej ndërmarrjeve respektive;

2. Kryejnë blerje të përbashkëta, por deklarimi në doganë bëhet në emër të një ndërmarrje;
3. Ndajnë shpenzimet e doganës, shpenzimet e transportit dhe shpenzime të tjera në masën 50 % me 50%.
4. Mbajnë të dhëna të sakta mbi detyrimet dypalëshe (arkëtimet dhe gjendjet debitore) të njëri tjetrit, sasinë e grurit të blerë dhe shpenzimet e zhdoganimit.
5. Zotërojnë së bashku 50.24% të tregut të importit të grurit, 34.67 % të tregut të shitjes së grurit, 50% të tregut të prodhimit të miellit (25% Atlas dhe 25% Bloja), teknologji dhe kapacitete të larta përpunimi, duke u bërë një faktor i fuqishëm që kufizon konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.
6. Kanë fuqi tregu për të shkaktuar kufizime të konkurrencës. Shkalla e përqendrimit të këtyre dy ndërmarrjeve është e lartë, fuqia kundërvepruese e të gjithë konkurrentëve të tjerë është me e vogël se e ndërmarrjeve Bloja sh.a dhe Atlas sh.a, fuqia kundërvepruese e klientëve (mullinj të vegjël dhe prodhues buke) është e vogël.
7. Sjellja e ndërmarrjeve në treg duhet të reflektojë konkurrencën e lirë dhe efektive.

Sa më lart, nga analiza e sjelljes së këtyre ndërmarrjeve në treg, vërtetohet ekzistenca e një praktike të bashkërenduar ndërmjet tyre, e cila në kuptim të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 3 pika 4 konsiderohet marrëveshje.

Bazuar në nenin 4 të Ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kjo marrëveshje konsiderohet marrëveshje e ndaluar, dhe bie në kundërshtim me pikën 1 gërmat a), b) dhe c) të këtij neni, pasi cakton në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes së miellit, kufizon dhe kontrollon tregun e shitjes së grurit dhe prodhimit të miellit, si dhe ndan tregun e shitjes së miellit, duke kufizuar në mënyrë të ndjeshme konkurrencën në treg.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d dhe nenin 45, pika 1 të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

## **V E N D O S I:**

1. Ndalimin e marrëveshjes në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit midis ndërmarrjeve "Atlas" Sh.a dhe "Bloja" Sh.a si marrëveshje e ndaluar në kuptim të nenin 4 të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

**Rezana KONOMI**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**